

Vendim nr. 211 datë 30.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 30.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (F) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **FLUTURA SHEHI, BAJRAM KOÇI**, përfaqësuar nga avokat Kadri Isufaj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5548, datë 04.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë në marrëdhënie të posaçme familjare me njëri-tjetrin, përkatësisht nënë e bir. Ata kanë qenë të strehuar në një objekt shtetëror, lavanderia e shkollës së mesme ekonomike në Tiranë, i cili është kthyer në banesa. Me vendimin nr. 8, datë 27.02.2015 të këshillit bashkiak Tiranë është vendosur përfundimi i procedurave të privatizimit të banesave shtetërore dhe lidhja e kontratave noteriale për shtetasit, banesat e të cilëve kanë mbetur pa u regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ku, ndër ata, ka qenë edhe kërkuesja Flutura Shehi. Mbi këtë bazë, me kontratën noteriale të shitjes (privatizimit) të datës 17.04.2015, Drejtoria e Përgjithshme nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë, u ka kaluar kërkuesve pronësinë për një apartament, banesa nr. 27/2, kati përdhe, me sipërfaqe prej 37 m², sipas planimetrisë dhe planit të vendosjes bashkëngjitur kontratës. Në kontratë është përcaktuar se edhe trualli mbetet në pronësi të shtetit sipas pikës 8 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 97, datë 03.02.2008 “Për procedurat e privatizimit të banesave, objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore dhe i ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyer në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore”” (VKM nr. 97/2008). Në datën 21.01.2016 apartamenti është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në pronësi të kërkuesve dhe ata janë pajisur me certifikatën e pronësisë.

2. Ndërkohë, në datën 13.02.2017, kërkuesit i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi kundër Bashkisë Tiranë dhe ndërmarrjes së saj, Drejtorisë së Përgjithshme nr. 3 të Punëtorëve të Qytetit, duke kërkuar detyrimin e tyre të përfundojnë procedurat e privatizimit edhe për truallin nën banesë me sipërfaqe 37 m² dhe të oborrit funksional të saj me sipërfaqe 260 m². Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 80-2017-1717, datë 25.04.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke vlerësuar se paditësit (kërkuesit) nuk kanë një interes material të ligjshëm në ngritjen e padisë, pasi, referuar pikës 9 të VKM-së nr. 97/2008, ndërsa janë përpara një objekti të kthyer në banesë, ata gëzojnë vetëm të drejtën e privatizimit të objektit, por jo edhe të truallit të tij, i cili vijon të mbetet pronë e shtetit, gjë që është përcaktuar edhe në kontratën e shitjes (privatizimit) të lidhur mes palëve ndërgjyqëse.

3. Për ankimin e kërkuesve, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 86-2023-359, datë 10.03.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, me të njëjtën linjë arsyetimi. Kurse për rekursin e paraqitur nga ata, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5548, datë 04.12.2023, në dhomën e këshillimit, ka

vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se në rekurs nuk parashtrohej asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

4. Në datën 27.05.2025 (*sipas zarfit postar*), kërkesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 09.06.2025.

II

Pretendimet e kërkesve

5. **Kërkesit**, në mënyrë të përmblodhur, kanë parashtruar se:

- 5.1. Nëse gjykata e shkallës së parë ka pasur paqartësi për objektin dhe shkakun e padisë, duhet t’i ishte referuar vendimit unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 3/2012*), duke analizuar padinë në tërësinë e saj.
- 5.2. Gjykata e apelit e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, gjë që ka bërë të pamundur kontaktin e paditësve (kërkesve) me gjykatën, për të parë kjo e fundit gjendjen reale të kërkeses si invalide. Po kështu, kjo formë gjykimi i ka vënë ata në pozita inferiore për sa i përket cilësisë së përfaqësimit. Ankimi i tyre mund të ketë pasur mangësi, ardhur kjo kryesisht nga mungesa e njohurive ligjore dhe nga mospasja e mundësive të mjaftueshme financiare për të pajtuar një avokat, gjë që ka bërë që ata të mos depozitonin, brenda afatit ligjor, as parashtrime me shkrim përpara shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Nëse gjykata do ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, kërkesit do të kishin pasur mundësi për të paraqitur prova të reja, të ballafaqoheshin me to dhe të bënë parashtrimet e tyre, çka mund të kishte çuar në një vendimmarrje tjetër të ndryshme nga ana e gjykatës.
- 5.3. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është mbështetur në një “vendim pilot” të tij, në vendimin nr. 00-2023-1699, datë 24.04.2023, i cili është dhënë nga një trup gjykues i përbërë nga 3 gjyqtarë, në një kohë kur sipas Kushtetutës kompetenca për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore i takon një trupi gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.

- 5.4. Gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka rrëzuar padinë si të pambështetur në ligj dhe në prova, pasi duke qenë se banesa është bashkuar me truallin, të paditurit kanë detyrimin ligjor për privatizimin edhe të truallit nën banesën e kërkuësve dhe atë funksional të saj. Edhe gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë shkaqet e ankimit të kërkuësve dhe vendimi i saj është kopje e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kolegji vëren se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuësit. Mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

8. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuësit kanë parashtruar argumente konkrete për procesin gjyqësor të kundërshtuar, por pa identifikuar ndonjë të drejtë kushtetuese të

cenuar atyre, ndonëse ankimi kushtetues individual është paraqitur nga një avokat i zgjedhur nga ata. Gjithsesi, nisur nga pretendimet, në thelb, të kërkuësve, bazuar në parimin *iura novit curia*, i cili vepron edhe në procesin kushtetues, sipas të cilit të drejtën, ligjin, e njeh gjykata dhe ajo bën cilësimin juridik të çështjes, Kolegji vëren se pretendimet kanë të bëjnë me të drejtën e kërkuësve për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur dhe të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, ndaj do të analizohen në vijim.

9. Në lidhje me pretendimin e kualifikuar në drejtim të së drejtës së aksesit, kërkuësit kanë parashtruar se nëse gjykata e shkallës së parë ka pasur paqartësi për objektin dhe shkakun e padisë, duhet t'i ishte referuar vendimit unifikues nr. 3/2012, duke analizuar padinë në tërësinë e saj. Megjithatë, Kolegji vëren se kërkuësit nuk tregojnë ndonjë gabim konkret të gjykatës së shkallës së parë në identifikimin e objektit dhe të shkakut ligjor të padisë së tyre dhe, në këtë kuptim, që ata të mos kenë marrë përgjigje pikërisht për të. Përkundrazi, referuar vendimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk duket që ajo të ketë pasur ndonjë paqartësi për objektin dhe shkakun ligjor të padisë së kërkuësve, ndërsa këta të fundit kanë marrë përgjigje përfundimtare për të. Për të drejtën e aksesit, Gjykata është shprehur se ajo përfshin të drejtën e individit për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 32, datë 19.05.2025; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, vetëm pretendimi i kërkuësve se gjykata e shkallës së parë nuk e ka pasur të qartë objektin dhe shkakun ligjor të padisë, në aspektin kushtetues është i pamjaftueshëm për të vënë në dyshim të drejtën e tyre të aksesit, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

10. Në lidhje me pretendimin e kualifikuar në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuësit kanë parashtruar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është mbështetur në një “vendim pilot” të tij, në vendimin nr. 00-2023-1699, datë 24.04.2023, i cili është dhënë nga një trup gjykues i përbërë nga 3 gjyqtarë, në një kohë kur sipas Kushtetutës kompetenca për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore i takon një trupi gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Në jurisprudencën e saj, Gjykata është shprehur se e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë kompetente dhe e caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet*

nr. 3, datë 07.02.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, Kolegji vëren se, sikundër nuk kundërshtohet as nga kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka pasur juridiksionin për shqyrtimin e çështjes dhe ajo vendimmarrje e tij është brenda kompetencave të njohura nga ligji për të.

11. Kolegji konstaton se pretendimi i kërkuesve në realitet konsiston në faktin e mbështetjes së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në rastin konkret në një vendim tjetër të tij, të konsideruar me vlerën e një “vendimi pilot”, i cili është marrë nga një trup gjykues i përbërë nga 3 gjyqtarë dhe, si i tillë, nuk ka vlerën e një vendimi njësues ose zhvillues që merret me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Kolegji vëren se në vendimin e kundërshtuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se kreu veprimtarinë seleksionuese për përmbajtjen e shkaqeve të rekursit të kërkuesve, pra nëse në të ngrihen ose jo (dukshëm) shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, në përputhje me procedurën e shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë së rekurseve dhe natyrën e veprimtarisë së tij seleksionuese, sipas nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile, për të cilat ka mbajtur qëndrim të zgjeruar në vendimin nr. 00-2023-1699, datë 24.04.2023, i cili është konsideruar të ketë vlerën e një vendimi pilot. Kolegji vëren se termi teknik “vendim pilot” i përdorur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në rastin konkret nuk duket se ka kuptimin e vendimit njësues ose zhvillues të praktikës gjyqësore, në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës, por ka kuptimin e një modeli të vepruari në rastet e shqyrtimit paraprak të rekurseve dhe për sa u përket kufijve të këtij shqyrtimi, i cili duket se është përfaqësuar nga trupat e ndryshëm gjykues të atij kolegji. Gjithsesi, referimi në atë vendim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, duket se është bërë në funksion të qartësisë së vendimit të tij në këtë rast dhe për të mos rënë në përsëritje për procedurën e shqyrtimit paraprak të ndjekur për pranueshmërinë e rekursit të kërkuesve dhe për kufijtë e këtij shqyrtimi, çka nuk mund të vërë në dyshim të drejtën e tyre për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

12. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesve në drejtim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

13. Në lidhje me pretendimin e kualifikuar në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur dhe të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, kërkuesit kanë parashtruar se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga gjykata e apelit: i) u ka pamundësuar atyre kontaktin me gjykatën, për të parë kjo e fundit gjendjen reale të kërkueses si invalide; ii) i ka vënë në pozita inferiore për sa i përket cilësisë së përfaqësimit, pasi në kushtet kur

ankimi i tyre mund të ketë pasur mangësi dhe në kushtet kur nuk kanë pasur një avokat, kjo si pasojë e mospasjes mjaftueshëm të mundësive financiare, ata nuk kanë arritur të depozitojnë brenda afatit ligjor parashtrime me shkrim përpara shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, ndërkohë që nëse çështja do të ishte shqyrtuar në seancë gjyqësore me praninë e palëve, ata do të kishin pasur mundësi për të paraqitur prova të reja, të ballafaqoheshin me provat dhe të bënë parashtrimet e tyre, çka mund të kishte çuar në një vendimmarrje tjetër, të ndryshme, nga ana e gjykatës.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta e mbrojtjes dhe ajo për t'u dëgjuar, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes (*shih vendimet nr. 9 datë 27.02.2024; nr.34, datë 29.05.2015; nr. 7, datë 12.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i kontradiktoritetit në gjykim dhe ai i barazisë së armëve kërkojnë krijimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose të përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe për deklaratimet e tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore për çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 9 datë 27.02.2024; nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra për komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas saj, procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkueses i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur (*shih vendimet nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Lidhur me procesin gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, neni 49 i ligjit nr. 49/2012 ka përcaktuar se shqyrtimi i ankimit në këtë gjykatë si rregull bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit, ndërsa palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim për shkaqet e ngritura në ankim dhe në kundërankim. Ndërkohë në nenin 51 të ligjit 49/2012 janë përcaktuar rastet kur Gjykata Administrative e Apelit, përjashtimisht, e shqyrton çështjen në seancë gjyqësore me praninë e palëve, ndër ato edhe kur për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë duhen

marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji. Ky i fundit përcakton se në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte, ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.

16. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji vëren se, sikurse pranohet edhe nga kërkuesit, gjykimi i çështjes gjykatën e shkallës së parë është zhvilluar në seancë gjyqësore me praninë e palëve, ndërsa kërkuesja është mbrojtur nga një avokat. Ata në vijim kanë paraqitur ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por nuk kanë kërkuar marrjen e ndonjë prove të re, të cilën, pa fajin e tyre, nuk kanë pasur mundësi për ta paraqitur gjatë gjykimit në shkallë të parë. Po kështu, ata nuk kanë paraqitur një kërkesë të tillë as përpara shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Kjo e fundit e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, ndërsa kërkuesit nuk kanë paraqitur as parashtrime me shkrim përpara seancës.

17. Nga sa rezulton, Kolegji vëren se Gjykata Administrative e Apelit, duke e shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, ka vepruar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Kjo formë gjykimi nuk duket se i ka vënë kërkuesit në pozita të pabarabarta, ndërsa ata kanë pasur mundësi të kërkojnë marrjen e provave të reja, gjë të cilën nuk e kanë shfrytëzuar. Përtej kësaj, as në atë rast, por edhe në vijim, përfshirë dhe në ankimin e tyre kushtetues individual, kërkuesit nuk tregojnë për pasjen e ndonjë prove me rëndësi për çështjen. Po kështu, kjo formë gjykimi nuk duket që t'u ketë pamundësuar atyre të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, për sa kohë kanë pasur mundësi të paraqisnin parashtrime me shkrim përpara shqyrtimit të çështjes për ankimin e tyre, por nuk e kanë shfrytëzuar. Nga ana tjetër, kërkuesit nuk argumentojnë se përse fakti i qenies invalide të kërkueses ka rëndësi për ligjin dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në rastin konkret dhe, në këtë kuptim, të përbënte arsye për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit në seancë gjyqësore me praninë e saj. Po kështu, ndonëse pretendojnë se nuk kanë pasur mjaftueshëm mundësi financiare për marrjen e një avokati, i cili t'u garantonte një cilësi më të lartë përfaqësimi në gjykimin në apel, përfshirë edhe për ushtrimin e së drejtës për të paraqitur parashtrime me shkrim përpara seancës në dhomën e këshillimit, kërkuesit nuk tregojnë që të kenë përdorur mjetet juridike të dhëna nga ligji për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti, sipas ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", përveçse nga aktet duket se ata e kanë siguruar vetë një ndihmë të tillë referuar mjeteve ligjore të përdorura.

18. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vetëm fakti se Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve nuk është i mjaftueshëm në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim të drejtën e kërkuësve për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuësve është haptazi i pabazuar.

19. Në lidhje me pretendimin e kualifikuar në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, kërkuësit kanë parashtruar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar kur ka rrëzuar padinë si të pambështetur në ligj dhe në prova, pasi duke qenë se banesa është bashkuar me truallin, të paditurit kanë detyrimin ligjor për privatizimin edhe të truallit nën banesën dhe atë funksional të saj. Edhe gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë shkaqet e ankimit të kërkuësve dhe vendimi i saj është kopje e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërkohë që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të tyre.

20. Gjykata ka pohuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pranuar se vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata në vijimësi është shprehur se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar është vënë në lëvizje me një padi të kërkuësve, të cilët, me pretendimin se gëzojnë të drejtën e privatizimit të truallit nën banesë dhe atij funksional të saj referuar legjislacionit për privatizimin e banesave dhe të objekteve, të kthyer në banesa, si dhe se kjo e drejtë nuk i njëhej nga pala e

paditur, kanë kërkuar detyrimin e saj për të përfunduar procedurat e privatizimit edhe për truallin nën banesë, edhe të oborrit funksional të saj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuësve, duke vlerësuar se ata nuk kanë një interes material të ligjshëm në ngritjen e padisë, pasi referuar pikës 9 të VKM-së nr. 97/2008, ndërsa janë përpara një objekti të kthyer në banesë, ata gëzojnë vetëm të drejtën e privatizimit të objektit, por jo edhe të truallit të tij, i cili vijon të mbetet pronë e shtetit, gjë që është përcaktuar edhe në kontratën e shitjes (privatizimit) të lidhur mes palëve ndërgjyqëse.

22. Çështja është shqyrtuar në vijim nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vlerësuar se në ankimin e kërkuësve nuk ngrihen shkaqe për cenimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e gjetur të drejtë përcaktimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit nga ajo. Ndërkohë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve, me arsyetimin se ata nuk kanë përcaktuar dhe as nuk kanë argumentuar në rekursin e tyre ndonjë prej shkaqeve për të cilat ligji lejon paraqitjen e rekursit, ndaj vendimi i gjykatës së apelit nuk mund të cenohet.

23. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme, Kolegji vëren se, në kundërshtim nga sa pretendojnë kërkuësit, gjykata e shkallës së parë ka bërë një analizë tërësore të pretendimeve të ngritura në padi përkundrejt provave dhe ligjit të zbatueshëm, duke arsyetuar mjaftueshëm qëndrimin e saj për shkaqet e rrëzimit të kërkesëpadisë. Qëndrimi i kësaj gjykate i është nënshtruar në vijim edhe vlerësimit të gjykatës së apelit, e cila e ka konsideruar atë në zbatim të drejtë të ligjit material, ndërkohë që Gjykata e Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, pasi ka listuar shkaqet e rekursit, ka konstatuar se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet për të cilat ligji lejon paraqitjen e tij dhe që mund të çojnë në cenimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Nisur nga kjo, Kolegji vlerëson se vendimet e gjykatave të zakonshme plotësojnë standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, ndërkohë që zbatimi nga ato i ligjit material nuk duket arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësve është haptazi i pabazuar.

24. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.